

14 – 16 Maj 2024**Grand Hotel Belushi
Rugovë, Kosova**

"Fuqizimi i Brezave të Rinjë të Ndërmarrjeve Familjare"

A jeni gati për mundësitë dhe sfidat që ju presin si pjesëtar i brezit të ri në ndërmarrjen e suksesshme familjare? Dëshironi të nxisni inovacionin dhe të udhëheqni biznesin e trashëguar nga familja?

Në kuadër të Kosova Business Forum dhe misionit të tij për Fuqizimin e atyre që sjellin ndryshime, AE Consulting Group organizon një program trajnimi të dedikuar: **"Fuqizimi i Gjeneratës së Re të Ndërmarrjeve Familjare"**.

Bashkohuni në programin tonë të trajnimit frymëzuar nga modelet më të mira të Universitetit të Harvardit, i cili do t'ju përgatisë për të planifikuar fazën tjetër të jetës suaj, për të përmbushur përgjegjësitë komplekse të një biznesi familjar dhe për të dhënë një kontribut të veçantë në pasurinë familjare.

Për kë është ky trajnim:

Ky program trajnimi është krijuar për anëtarët e brezit të ri të ndërmarrjeve familjare, të cilët mund të jenë ose jo të përfshirë aktualisht në menaxhimin e biznesit familjar, por që po përgatiten për role të reja drejtuese ose role të tjera angazhuese në ndërmarrjen familjare dhe që kanë dëshirën të japin një kontribut domethënës në bizneset e tyre familjare.

Pse duhet të merrni pjesë:

- Për të analizuar opsionet dhe për të zgjedhur rolin e duhur për ju në ndërmarrjen familjare;
- Për të mësuar të menaxhoni bisedat e vështira me anëtarët e familjes teksa përgatiteni për të ardhmen;
- Për të krijuar një stil unik lidhësi, thelbësor për nxitjen e ndryshimeve pozitive dhe inovacionin brenda biznesit familjar;
- Për të forcuar një mendësi sipërmarrëse që është e qëndrueshme dhe e përshtatshme për të adresuar në mënyrë efektive sfidat e reja në tregun e Kosovës dhe më gjerë;
- Për t'u fuqizuar për të zbatuar zgjidhje të gjeneratës së re dhe për t'u bërë katalizatorë të rritjes dhe zhvillimit, duke respektuar në të njëjtën kohë historikun e biznesit familjar;
- Për të zgjeruar rrjetin tuaj personal dhe profesional me sipërmarrës të ngjashëm me

Çfarë do të mësoni:

Nëpërmjet prezantimeve të trajnerëve, diskutimeve në grup, shembujve të rasteve reale dhe folësve të ftuar, ju do të merrni përgatitje shtesë për rolin tuaj si pjesë e gjeneratës së re në ndërmarrjen familjare. Ju do të keni mundësinë të kuptoni më mirë aspiratat tuaja profesionale ndërsa eksploroni tema si:

- ✓ Vendimmarrja se në cilin rol dëshironi të kontribuoni në biznesin tuaj familjar;
- ✓ Përcjellja e dinamikës unike të biznesit familjar;
- ✓ Analizimi i roleve të pronarit VS menaxherëve;
- ✓ Krijimi i një procesi për kalimin e pronësisë/menaxhimit nga një gjeneratë tek tjetra dhe futja në kompani e talentëve të rinj jo familjar, duke respektuar gjithmonë historikun e biznesit;
- ✓ Zbatimi i praktikave më të mira të qeverisjes kooperative;
- ✓ Planifikimi i vazhdimësisë së drejtimit të biznesit dhe menaxhimi i periudhës tranzitore.

Agjenda

Dita 1 – 14 Maj

16:00 – 19:00 *Mbërritja dhe Regjistrimi*

19:30 – 21:30 *Darkë Rrjetëzimi* Njohja me njëri-tjetrin

Dita 2 – 15 Maj

08: 00 – 09:00 *Mëngjesi*

09:00 – 10:30

Profesionalizimi i biznesit familjar

– Nga menaxhimi i sipërmarrjes në menaxhimin profesional

10:30 – 11:00 *Pushimi i kafes*

11:00 – 12:30

Modeli 3–ciklesh i Sistemit të Biznesit Familjar

- Kuptimi i pozicioneve të Modelit 3–ciklesh
- Struktura e biznesit
- Struktura e familjes
- Sturktura e pronësisë

12:30 – 13:30 *Pushimi i drekës*

13:30 – 14:30

Diversiteti i trashëgimtarëve: Sjellja e inovacionit duke respektuar historikun e kompanisë

Strategjitë për zgjidhjen e konflikteve

14:30 – 15:30

Struktura dhe planet për menaxhimin e zhvillimit.

- Dimensioni familjar
- Dimensioni i pronësisë
- Dimensioni i biznesit

15:30 – 16:30 *Pyetje & Përgjigje*

19:00 – 21:00 *Darkë Rrjetëzimi*

Dita 3 – 16 Maj

08: 00 – 09:00 *Mëngjesi*

09:00 – 10:15

- Punëtori për strukturën familjare

10:15 – 10:30 *Pushim*

10:30 – 11:45

- Punëtori për strukturën familjare

11:45 – 12:00 *Pushim*

12:00 – 13:00

- Punëtori për strukturën familjare

13:00 – 14:00 *Pushimi i drekës*

14:00 – 15:00

Folësi i ftuar – ndarja e eksperiencës personale.

Këshilla për trashëgimtarët për një tranzicion të suksesshëm

15:30 – 16:30

Vetë-vlerësimi i nivelit të planifikimit të pjesëmarrësve dhe hapat e mëtejshëm

Diskutim dhe Pyetje & Përgjigje

16:30

Kthimi

Ju lutemi mbani në konsideratë se kjo agjendë mund të ndryshoj

Fuqizim. Njohuri. Rrjetëzim.

Pjesëmarrja në "Fuqizimi i Gjeneratës së Re të Ndërmarrjeve Familjare" përfaqëson një investim strategjik në qëndrueshmërinë dhe suksesin e ardhshëm të bizneseve tuaja familjare.

Duke e pajisur brezin e ardhshëm me aftësitë, njohuritë dhe sistemet e nevojshme mbështetëse, ne synojmë t'i fuqizojmë ata për të nxitur ndryshime pozitive, inovacion dhe udhëheqje etike brenda ndërmarrjeve të tyre familjare.

Ju do të përfitoni një eksperiencë të pasur dhe frymëzuese mësimore dhe do të angazhoheni në mundësitë e rrjetëzimit që do të pasurojnë karrierën tuaj profesionale dhe jetën personale.

PROCESI I REGJISTRIMIT

Megjithëse nuk ka kërkesa formale për përvojën arsimore dhe profesionale, procesi i pranimi është shumë selektiv, bazuar në arritjet tuaja profesionale dhe përgjegjësitë tuaja organizative aktuale ose të ardhshme brenda ndërmarrjes familjare. Ne duam të sigurohemi që të gjithë pjesëmarrësit të jenë në faza të ngjashme të zhvillimit të karrierës, në mënyrë që të përfitoni sa më shumë nga ky program dhe të angazhoheni me entuziazëm në mundësitë e rrjetëzimit.

Ne pranojmë kandidatë bazuar në disponueshmërinë e vendeve të lira, pasi që numri është i kufizuar në 15 pjesëmarrës për këtë sesion trajnimi. Prandaj, ju inkurajojmë të aplikoni sa më shpejt!



Periudha e regjistrimit: 1 Prill – 1 Maj 2024

Procesi i regjistrimit: Shprehni interesimin tuaj – CV-në tuaj dhe një elaborim se pse dëshironi të merrni pjesë – në info@aecg.net dhe ekipi ynë do t'ju kontaktojë me një konfirmim të kërkesës suaj për regjistrim brenda 5 ditëve të punës.

Kërkesat për gjuhën: Anglisht

Çmimi: 1100 Euro - përfshin: trajnimin dhe materialet e trajnimit, akomodimin në hotel (dhomat standarde), darkat e rrejtëzimit dhe vaktet e tjera ushqimore sipas agjendës.

PËR MË SHUMË INFORMATA:

Empowering Events - www.kosovabusinessforum.com

PËR NJË KONSULTIM INDIVIDUAL:

Rezervoni takimin online me Koordinatorin e Programit

Ms. Elena Pici

Email: e.pici@aecg.net

Phone: +355 69 63 38 660

Vizitoni zyret tona në: Rr. Ahmet Krasniqi, nr. 13, Prishtina

Ky trajnim është bashkë-financuar nga EBRD nëpërmjet Fondit Special të Luksemburgut për Bizneset e Vogla – "Small Business Impact Fund"

